



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 591 Prot.

Tiranë, më 20/09/2023

VENDIM

Nr. 36, DATË 20/09/2023

MBI

**“MIRATIMIN E PUNËSIMIT TË 1 (NJË) PUNONJËSI MËSIMOR (PERSONALITET)  
NË FAS, PRANË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, ME KONTRATË ME  
KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ANGAZHIM ME KOHË TË PLOTË  
MËSIMORE, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 (Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), neni 38 (Funkcionet e Senatit Akademik), neni 62 (Personeli akademik i ftuar), të Statutit të UART, neni 58, pika 3, bazuar në kërkesën e FAS bashkëlidhur vendimit, pas diskutimeve, Senati Akademik në mënyrë unanime dhe me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Fakultetit të Artit Skenik, për punësimin e **Dr. Primo SHLLAKU**, si punonjës me kontratë (Personalitet), për vitin akademik 2023-2024.
2. Ky vendim të shoqërohet në Bordin e Administrimit për miratim.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



Nr. 159 Prot FAS

20.06.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 591/prot.

Tiranë, më 20/06/2023

**Lënda:** *Kërkesë për punësim personeli akademik të ftuar me kontratë*

**Drejtuar** **REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE**  
**Prof. KASTRIOT ÇAUSHI**

I nderuar zoti Rektor,

Përgjegjësit e tri Departamenteve të FAS në datë 19.06/2023 për të rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e zhvillimit të disa lëndëve teorike që i shërbejnë formimit të studentit si Histori Teatri (shqiptar, botëror), Histori Teatri Bashkëkohor, Teori Drame, Histori e Kinemasë ju janë drejtuar me një kërkesë specifike në dobi të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies në të dy ciklet e studimit.

Në kërkesën e dërguar ata kanë shprehur gjithë argumentat e propozimit të tyre që ashtu si edhe vitin e kaluar të ofrojnë një personel akademik me kontratë 1 (një vjeçare). Dhe kjo kërkesë mendoj se është e bazuar në Ligjin Nr 80//2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu VI Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë, Neni 62, pika 1 që shprehet se "Njësitë Bazë të Institucioneve të Arsimit të Lartë kanë të drejtë të kërkojnë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës, personalitete, artistë vëndas ose të huaj".

Po ashtu kërkesa mbështetet gjithashtu edhe në statutin e UART, në nenin 58 që trajton "Personelin akademik të ftuar". Pika 2 e këtij neni thekson se për të plotësuar nevojat, me propozim të Njësisë Bazë, miratim të Dekanit të Fakultetit, punonjësi mësimor i ftuar miratohet përfundimisht në Senatin e UART.

Kërkesa e shefave të departamenteve ka qënë e njëjtë me vitin e kaluar, dhe konkretisht për të angazhuar si pedagog të ftuar pranë FAS Dr. Primo Shllaku, i njohur për rolin e tij në dobi të artit. Në kërkesën e paraqitur prej përgjegjësve të njësisë bazë ndodhet edhe vlerësimi i punës pedagogjike për vitin 2022-2023. Ne mendojmë se kemi të bëjmë me një personalitet në këtë fushë, profesionist që gjithmonë ka treguar seriozitet në punën e tij si pedagog pranë FAS.



Duke menduar se jemi në kohë për të filluar një vit akademik normal do ju kërkonim ndjekjen procedurave të mëtejshme për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.

Ju faleminderit !

DEKANI

Prof. Petrit MALAJ



FAKULTETI I ARTIT SKENIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 19/06/2023

**Lënda :** *Kërkesë për punësim personeli akademik me kontratë për vitin akademik 2023-2024*

**Drejtuar:** REKTORIT TË UART  
PROF.KASTRIOT CAUSHI  
DEKANIT TË FAS  
PROF.PETRIT MALAJ

Të nderuar profesorë !

Në disa Programe Studimi të FAS dhe konkretisht në Aktrim, Regji dhe Skenografi, janë të miratuara në planet mësimore dhe zhvillohen prej vitesh disa lëndë teorike që i shërbejnë formimit të studentit si Histori Teatri, Teori Drame, Histori e Kinemas etj. Gjatë këtyre viteve këto lëndë janë mbuluar nga pedagogë të ftuar.

Ne , përgjegjësit e tri Departamenteve të FAS, për të rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e zhvillimit të këtyre lëndëve ju drejtohem me një kërkesë specifike që mendojmë se do të jetë në dobi të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies në të dy ciklet e studimit. Nga përlogaritja e orëve që mbulojnë këto lëndë në Planin Mësimor del që kemi të bëjmë me një ngarkesë mbi 200(dyqind) orë mësimore vjetore. Nisur nga sa më sipër ne propozojmë të marrim një personel akademik me kontratë 1 (një vjeçare). Këtë kërkesë e bazojmë në Ligjin Nr 80//2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu VI Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë, Neni 62, pika 1 që shprehet se *'Njësitë Bazë të Institucioneve të Arsimit të Lartë kanë të drejtë të kërkojnë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës ,personalitete,artistë vëndas ose të huaj'*.

Kjo kërkesë mbështetet gjithashtu edhe në statutin e UART, në nenin 58 që trajton *'Personelin akademik të ftuar'* . Pika 2 e këtij neni thekson se për të plotësuar nevojat, me propozim të Njesisë Bazë dhe miratim të Drejtuesit të Njesisë Kryesore, personeli akademik i ftuar miratohet përfundimisht në Senatin e UART.

Ne për shumë vite kemi angazhuar si pedagog të ftuar dhe vitet e fundit si pedagog me kontratë pranë FAS një personalitet të tillë si Dr.Primo Shllaku, i njohtur për rolin e tij në dobi të artit. Ne mendojmë se kemi të bëjmë me një personalitet në këtë fushë, profesionist që gjithmonë



ka treguar seriozitet në punën e tij si pedagog i ftuar pranë FAS.

Dr. Primo Shllaku asnjëherë nuk e ka ndarë punën e pedagogut nga ajo e një kërkuesi shkencor në fushën e artit dhe të letërsisë .Botimet dhe qëndrimet e tij e bëjnë atë një pedagog që të jetë i kërkuar nga vetë studentët.

Ai si një njohës shumë i mirë i gjuhës latine është edhe një orientues shumë i mirë dhe i veçantë për studentët e artit skenik .


Ne duke u bazuar në vlerësimet, përkushtimin e treguar prej tij gjatë kohës që është angazhuar si pedagog me kontratë, kualifikimin dhe potencialin që zotëron, theksojmë edhe njëherë që Dr.Primo Shllaku është një personalitet që në përputhje me vetë politikat e FAS për rekrutimin pranë saj të personaliteteve të spikatura në fushën e tyre, do t'i shërbej rritjes cilësore të pergatitjes së studentëve të FAS .

Si përfudim do të kërkonim nga ju që kërkesa jonë të merret në konsideratë në dobi të një procesi mësimdhënës cilësor si dhe në të mirën e studentëve të UART .

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën e Dr. Primo Shllakut bashkë me CV.

Ju faleminderit !


DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI

Prof. Gazmend GJOKA 

DEPARTAMENTIT SKENOGRAFI, KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI

Prof.asoc. Taulant PUSTINA 

DEPARTAMENTIT REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVIZIONI

Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ 

Dr. Primo SHLLAKU gjatë vitit akademik 2022-2023 ka qënë i angazhuar në Departamentin Aktrim dhe Teori në Fakultetin e Artit Skenik si pjesë e trupës pedagogjike me kontratë 1 (një) vjeçare.

Zoti Primo Shllaku mban gradën shkencore Doktor, është pjesë e nivelit B2 si Lektor i parë dhe është angazhuar në mësim në tre departamentet pjesë e Fakultetit të Artit Skenik. Ai është angazhuar edhe te Fakulteti i Arteve të Bukura.

Z. Shllaku ka dhënë mësim në programet e ciklin e parë BA dhe në ciklin e dytë të studimeve Master. kategorisë A/1 ose A/2.

Ne për shumë vite e kemi angazhuar si pedagog të ftuar dhe me kontratë pranë FAS një personalitet të tillë si Dr Primo Shllaku, i njohur për rolin e tij në dobi të artit Ne mendojmë se kemi të bëjmë me një personalitet në këtë fushë, profesionist që gjithmonë ka treguar seriozitet në punën e tij si pedagog pranë FAS.

Dr. Primo Shllaku asnjëherë nuk e ka ndarë punën e pedagogut nga ajo e një kërkuesi shkencor në fushën e teatrit, artit dhe të letërsisë . Botimet dhe qëndrimet e tij e bëjnë atë një pedagog që të jetë i kërkuar nga vetë studentët.

Ai si një njohës shumë i mirë i gjuhës latine është edhe një orientues shumë i mirë dhe i veçantë për studentët e artit skenik .

Ne duke u bazuar në vlerësimet, kualifikimin dhe potencialin që zotëron, theksojmë edhe njëherë që Dr. Primo Shllaku si personalitet ka qënë shumë i dobishëm me punën e tij pedagogjike dhe ka patur rezultate shumë të mira në komunikimin profesional me studentët tanë si dhe ka vendosur një raport shumë të mirë me kolegët pedagogë të FAS. Dhe themi me bindje se në në përputhje me politikat e FAS për rekrutimin pranë tij të personaliteteve të spikatura në fushën e tyre, Dr. Primo Shllaku i ka shërbyer rritjes cilësore të përgatitjes së studentëve të FAS . Zoti Shllaku ka qënë për gjatë vitit akademik anëtar i komisionit të provimeve të lëndëve në ciklin e parë BA dhe të dytë MA dhe po ashtu edhe të diplomave.

Si përfudim ne shprehim kënaqësinë tonë profesionale për bashkëpunimin që patëm me z. Shllaku gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe do të kërkonim që ky bashkëpunim të merret në konsideratë për ta patur në vazhdimësi gjithmonë në dobi të një procesi mësimdhënës cilësor si dhe në të mirën e studentëve të UART .

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Aktrim dhe Teori  
Prof. Gazmend GJOKA



Tirane 19/06/2023

## KËRKESË

**Drejtuar : Rektorit të UART**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik**

**Prof.Petrit Malaj .**

**Departamentit Aktrim dhe Teori Arti**

**Prof. Gazmend GJOKA**

Të nderuar drejtues të UART,

Gjatë këtyre viteve kam patur një bashkëpunim shumë të mirë me Ju dhe Fakultetin që drejtoni, dhe e gjitha kjo ka lënë një mbresë pozitive tek unë. Unë si pedagog i ftuar përgjatë këtyre viteve jam munduar të jem në lartësinë e kërkesave që ka vendosur fakulteti. Gjithashtu jam munduar që të jem bashkëpunues duke e vlerësuar punën e pedagogut të Lëndëve teorike, lëndë që lidhen ngushtë me perceptimin e studentit për artin, historinë e tij dhe rolin që ka luajtur dhe luan arti në shoqëri .

Gjatë këtyre viteve si pedagog i ftuar i kam dhënë shumë rëndësi përgatitjes së leksioneve për secilën nga lëndët që unë mbuloj si në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve master qoftë në FAS ashtu edhe në FAB.


Në këto kushte , unë do kërkoja nga Ju të më jepet mundësia që ashtu si dhe vitin e kaluar edhe përgjatë këtij viti akademik të punësohem si pedagogë i ftuar me kontratë pranë Departamentit Aktrim &Teori në Fakultetin e Artit Skenik.

Bashkëngjitur me kërkesën time po ju nis edhe një CV timen.

Ju faleminderit!

Me respekt

Dr. Primo Shllaku





# CURRICULUM VITAE

## 1. Të dhëna personale

- Dr Primo Shllaku
- Datë lindja 16.12.1947 Shkoder

## 2. Arsimimi dhe Eksperienca Akademike

- Shkolla e Mesme - Elbasan
- Universiteti Tiranë, Fakulteti Histori – Filologji , Dega Gjuhë – Letërsi Shqipe
- Mësues i Gjuhë – Letërsi Shqipe në Malësinë e Shllakut dhe Prekal
- Mësues Shkolla e mesme pyjore Shkodë ( 1982- 1990 )
- Pedagog i Latinishtes në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër (1988-1990)
- Mësues i Gjuhëve të Huaja në Emigracion në Greqi ( 1991-2006)
- Pedagog në Katedrën e Gjuhës Shqipe në Beograd (2007-2010)
- Shkolla e Doktoraturës pranë QSA ( 2010 – 2011)
- Doktor i Shkencave Letrare
- Pedagog i Ftuar në Fakultetin e Artit Skenik dhe në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve Tiranë
- Anëtar i Insitutit për Promovimin e Vlerave të Gjuhës Shqipe ( 2009)
- Anëtar i i Grupit organizator të dy konferencave Kombëtare për Promovimin e Vlerave të Gjuhës Shqipe në Tiranë, 2011 dhe Elbasan 2014.

## 3. Veprat

- Lule Nate –Poezi 1994
- Hana e Njelmët e ditës –Poezi 1995
- Edhe fjalët shkojnë në ferr – 2005
- Kosova - Saga e Ballkanit ( Refleksione mbi Kosovën) 2002
- Një Uliks që nuk mbrriti kurrë në Itakë 2005 (Vështrim kritik mbi Martin Camajn)



- Studime kritike-Një letërsi tjetër 2021
- Një letërsi tjetër (Mbi dsidencën shqiptare 1945-1990) 2021
- Romani -Pesha e papërballueshme e pafajsisë

#### 4.Përkthime

- Arshi Pipa –Politika Gjuhësore në Shqipërinë Socialiste (2007)
- Arshi Pipa –Vargu Popullor i Folklorit Shqiptar 2012
- Tzvetan Todorov- Kkonkuista e Amerikës. 2010
- Francois de Chateaubriand – Kujtime të përtej varrit - 6 vëllime 2018
- Charles Baudelaire - Lulet e së keqes. 2018
- Jean –Paul Sartre - Baudelaire (ese) 2018
- Franz Kafka - Shpërndërimi (Metamorfoza) 2018
- Viktor Hygo-Kadetalja e Sën Mërisë së Parisit 2020
- Daniello Kish- Mansarda 2021
- G. Flober-Zonja Bovari 2022
- A. Gide – Simfonia pastoral-2022
- R. Clair – Përsiatje mbi kinemanë-2022

#### 5. Veprimtari

Pjesmarrës në një numër të madh festivalesh kombëtare dhe ndërkombëtare të poezisë në Tiranë, Kosovë, Lopdëve de Sete në Francë, Genova në Itali, Rramallah në Palestinë etj

Në 03/11/2022 zhvilluar në Tiranë dy tubime IPVGJSH lidhur me gjuhën e përbashkët.

Ky tubim u zhvillua edhe në Shkodër në 20/05/2023.